



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



01n

42/02-34468

Dt: 04.07.2025

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 25 të Ligjit Nr.08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje Dhuna Ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjimore, nenit 4 të Rregullores (Qrk) – Nr. 01/2025 për Mekanizmin Koordinues Lokal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna Ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjimore, si dhe nenit 44 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke vendosur lidhur me Krijimin e Mekanizmit Koordinues Lokal për mbrojtje nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në bazë gjimore, me datë 04.07.2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Mekanizmi Koordinues Lokal për mbrojtje nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në bazë gjimore në Komunën e Gjakovës, në këtë përbërje:
 - 1.1 Kryetari i Komunës – kryesues
 - 1.2 Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
 - 1.3 Drejtor i Qendrës për Punë Sociale
 - 1.4 Udhëheqësi i Shërbimeve Sociale
 - 1.5 Drejtorja e Arsimit
 - 1.6 Zyrtarja për Barazi Gjimore
 - 1.7 Drejtori i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare
 - 1.8 Përfaqësues nga Zyra për Komunitete dhe Kthim
 - 1.9 Përfaqësues nga Strehimoret në Komunën e Gjakovës
 - 1.10 Përfaqësues nga OJQ-të e Komunës së Gjakovës që janë aktive në të drejtat e njeriut/grave.
2. Në bazë të nenit 9 të Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjimore, ftohen të jenë pjesë në Mekanizmin Koordinues Lokal:
 - 2.1 Mbrojtësi i Viktimave nga Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave;
 - 2.2 Përfaqësues nga Gjykata
 - 2.3 Përfaqësues nga Prokuroria
 - 2.4 Përfaqësues nga Policia
 - 2.5 Përfaqësues nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas
 - 2.6 Përfaqësues nga Zyrat e Punësimit
 - 2.7 Përfaqësues nga Qendra e Shëndetit Mendor.

3. Mekanizmi Koordinues Lokal sipas nevojës mund të ftojë në takim edhe përfaqësues të institucioneve relevante.
4. Udhëheqësja e Sektorit për të Drejta të Njeriut, znj. Lumnije Shllaku caktohet përgjegjëse për Sekretarinë e Mekanizmit Koordinues Lokal.
5. Detyrat dhe përgjegjësitë e Mekanizmit Koordinues Lokal në Komunën e Gjakovës përcaktohen në nenin 5,6 dhe 7 të Rregullores (Qrk) – Nr. 01/2025 për Mekanizmin Koordinues Lokal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna Ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjimore, si dhe konform dispozitave ligjore në fuqi.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi i'u dorëzohet:

- Zyrës së Kryetarit të Komunës
- Të gjithë institucioneve përkatëse.
- Arkivit.

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës

